



INSTITUCIONET E PËRKOZHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA
VLADA
GOVERNMENT

KRYEMINISTRI
PREMIER
PRIME MINISTER

**UDHËZIM ADMINISTRATIV I KRYEMINISTRIT NR. 8/2005
PËR PËRSHKRIMIN E DETYRAVE TË NJËSISË PËR TË DREJTAT E
NJERIUT**

Kryeministri i Kosovës,
Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, të datës 13 shtator 2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, Nenin 5.4, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/18 të datës 7 qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Rregulloren e UNMIK-ut Nr 2004/32 mbi shpalljen e Ligjit Kundër Diskriminimit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/15 të datës 16 mars 2005, Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 6/155 të datës 05.07.2005, si dhe Vendimin e Kryeministrit të Kosovës të datës 21 korrik 2005 (Nr. 055), nxjerr Udhëzimin Administrativ ZKM Nr. 8/2005 për përshkrimin e detyrave të Njesisë për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Qeverisë së Kosovës.

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Bazuar në vendimin e Kryeministrit të Kosovës të datës 21 korrik 2005 (Nr. 055) secila Ministri e Qeverisë së Kosovës themelon Njësinë për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me dispozitat pozitive të Shërbimit Civil të Kosovës
- 1.2 Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore në Zyrën e Kryeministrit (me tej ZQM) koordinon aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e akteve të miratuara nga Qeveria dhe dokumenteve ndërkombëtare relevante, e që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Neni 2

Qëllimi

- 2.1. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të bëjë përshkrimin e detyrave të Njesisë për të Drejtat e Njeriut.
- 2.2. Formimi i Njesisë për të Drejtat e Njeriut në secilën Ministri ka për qëllim promovimin, avansimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 3

Arsyeshmëria

- 3.1 Njësia për të Drejtat e Njeriut do të ndihmojë në zbatimin e dokumenteve të miratuara nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës,
- 3.2 Njësia për të Drejtat e Njeriut do të këtë rol të rëndësishëm në proceset e raportimit lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në ministrinë përkatëse.

Neni 4

Struktura

- 4.1. Njësia për të Drejtat e Njeriut i përgjigjet drejtpërdrejt sekretarit të përhershëm.
- 4.2. Njësia për të Drejtat e Njeriut përbëhet nga 3-7 zyrtarë, dhe udhëhiqet nga Koordinatori i Njesisë.

4.3. Zyrtarët përkatës do të mbulojnë këto sfera të të drejtave të njeriut: mundësitë e barabarta, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e minoriteteve (komuniteteve), të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuar, dhe anti-trafikut dhe qenieve njerëzore.

Neni 5

Koordinatori i Njesisë për të Drejtat e Njeriut

- 5.1 Koordinatori i Njesisë për të Drejtat e Njeriut drejtpërdrejt do t' i raportojë sekretarit të përhershëm të ministrisë.
- 5.2 Koordinatori i Njesisë për të Drejtat e Njeriut do të koordinojë aktivitetet në Ministrinë përkatëse në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë.
- 5.3 Koordinatori i Njesisë:
 - i) Koordinon dhe mbikëqyr aktivitetet e Njesisë për të Drejtat e Njeriut;
 - ii) Planifikon punën e Njesisë për të Drejtat e Njeriut, si dhe siguron organizimin dhe funksionimin efikas të saj;
 - iii) Planifikon aktivitetet e Njesisë për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve, përcaktimin e buxhetit të nevojshëm, si dhe përcakton nevojat për përkrahjen këshilluese nga jashtë;

Neni 6

Raportimi

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe ZQM bashkërendojnë aktivitetet në takimet e rregullta mujore të cilat do të kryesohen nga ZQM.

ZQM përgatit për Qeverinë raportet monitoruese me shkrim çdo 3 (tre) muaj.

Raportet do të jenë publike.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për të Drejtat e Njeriut

- 7.1 Njësia për të Drejtat e Njeriut (më tutje NjDNj):
- i) NjDNj do të zhvillojë politika dhe udhëzime në lëmin e respektimit të të drejtave të njeriut në kuadër të ministrisë;
 - ii) NjDNj do të bashkëpunojë me Institucionin e Ombudspersonit; Gjithashtu NjDNj do të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Ombudspersonit.
 - iii) NjDNj vlerëson zbatimin e të drejtave të njeriut në nivelin e ministrisë;
 - iv) NjDNj merr pjesë në draftimin e ligjeve si dhe akteve të tjera nënligjore;
 - v) NjDNj bën promovimin e të drejtave të njeriut,
 - vi) NjDNj kujdeset për zbatimin e ligjeve të cilat aprovohen nga Kuvendi i Kosovës, e të cilat janë në kuadër të përgjegjësisë dhe kompetencave të ministrisë përkatëse.
 - vii) NjDNj bashkëpunon me strukturat e nivelit komunal dhe OJQ-të në sferën e promovimit, avansimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
 - viii) NjDNj merr pjesë në mënyrë aktive në punën e grupeve të ndryshme ndërministrore;
 - ix) NjDNj këshillon vendimmarrësit në ministri lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut.


Neni 8

Ky Udhëzim hyn në fuqi më 11 gusht 2005.

Prishtinë

Më 11 gusht 2005

Kryeministri i Kosovës



Bajram Kosumi